

**GSK-KPA-A-019-2016**

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, bazuar në nenin 16 të Ligji nr. 03/1-079 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, Kolegji i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Nebojša Boričić, anëtarë me bashkepunëtor profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të **Palës ankuese** :

**G. D.**, Novi Sad, Serbi

**Kundër: A. B. - Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra Rajonale –Pejë,** Rruga “ Vllëzërit Gërvalla” nr. 254/7, Pejë

Duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tutje: KKPK), KPCC/D/C/248/2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës ( më tej AKP) me numrin KPA...) të datës 18 Qershor 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 20 Maj 2019, mori këtë:

## **AKTGJYKIM**

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e G. D., e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/248/2014 (kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA...) i datës 18 Qershor 2014.**
- 2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/248/2014 sa i përket kërkesës me numrin KPA... i datës 18 Qershor 2014.**

### **Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike**

1. Më 30 Tetor 2006, G. D., (në tekstin e mëtejme, pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), me të cilën ka kërkuar kthimin e posedimit të lokalit afarist që ndodhen në rrugën ish Nemanjina Nr.1 Pejë, ngastra kadastrale nr. ..., prona e kërkuar është njeri prej lokaleve me sipërfaqe prej 36 metra katrorë. Ai pohon se pronën e kërkuar e ka blerë me 7 Tetor 1998 nga J. J., dhe se e ka humbur si pasojë e konfliktit të armatosur dhe tani nuk e di se kush e shfrytëzon pronën e kërkuar.
2. Së bashku me kërkesën kishte dorëzuar në AKP *mes tjerash* dokumentet vijuese;
  - Kontratë e shitblerjes Ov.Br. ... datë 7 Tetor 1998 e lidhur në mes të palës ankuese dhe J. J., mbi shitjen e pronës së kërkuar për çmim prej 250.000.00 dinarë.
  - Autorizim i dhënë nga pala ankuese për R. F. avokat nga ...i Malit të Zi.

- Fleta poseduese nr. 2 që d.shmon se ngastra 1410/2 ishte e regjistruar n. emër të 16 bashkëpronarëve (njeri ndër ta edhe shitësi J. J.)
3. Agjencia Kosovare e Privatizimit me 5 Prill 2013 ka derguar shkresën me të cilën ka njoftuar se prona e kerkuar është në kompleksin e lokaleve të planifikuara për ndërtim në ngastrat 1410 dhe 1411 por që kanë mbetur të papërfunduara.
  4. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, kishte bërë njoftimin për kërkesën me datë 17 Korrik 2007 dhe 17 Prill 2013 , ku ishte gjetur se prona e kërkuar ishte dyqan. Me 26 Janar 2009 A. B. në emër të Agjencisë Kosovare të privatizimit duke pretenduar se është kompetente për adminstrimin e asateve të Ndërmarrjes Shoqerore “: ...” si pasardhëse e ish ndërmarrjes “M...” nga Peja e cila është futur në proces të likuidimit në vitin 2005. Lokalet e permendura jane shitur në vitin 2007 dhe 2008.
  5. Sipas raportit të verifikimit të Sekretarisë të AKP-së, të datës, është verifikuar pozitivisht dokumentacioni por është gjetur se Bartësi i të drejtës pronësore e ka shitur pronën tek një blerës i ri pas konfliktit dhe se e ka bërë të pamundeshme shfrytezimin e pronës nga pala ankuese.
  6. Sekretaria ka gjetur se sipas Certifikatës për paluajtshmeri me numër.Ul..., lëshuar nga zyra kadastrale Pejë , e datën 23 Prill 2014 e cila paraqet pronën e kërkuar të regjistruar në emra të 16 bashkëpronareve në mesin e ture edhe Janko Janković.
  7. Më 18 Qershor 2014, KKKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/C/248/2014 (në tekstin e mëtejme: (Vendimi i KKKPK-së), e ka hedhë poshtë kërkesën duke u bazuar në faktin se pala ankuese ka lidhur kontratë me vetëm njerin prej 16 bashkëpronarëve dhe se nuk e ka marre në posedim pronën dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohet se e ka humbur pronën si pasojë e konfliktit të armatosur ose rrethanave qe lidhen me të.
  8. Vendimi i KKKPK-së i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës(në tekstin e më tejme pala ankuese), më datë 04 Mars 2015, i njëjti kishte paraqitur ankesë më 24 Mars 2015. Palës përgjegjëse në ankesë i është dorezuar vendimi i KKKPK-së me 07.11. 2014.
  9. Me 22 Qershor 2016 u njoftua pala përgjegjëse me një kopje të ankesës dhe nuk u përgjigj ne afatin e parapare ligjor

### **Pretendimet e palës ankuese**

10. Pala ankuese thekson se; Vendimi i KKKPK-së përmban shkelje thelbësore të rregullave procedurale, zbatim të gabuar të së drejtës materiale, dhe vërtetim jo të saktë dhe jo të plotë

të gjendjes faktike të cilat shkelje janë të rëndësishme për vendosje lidhur me kërkesën për vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe kthimin e posedimit në pasurinë e kërkuar, e që nga kjo rezulton se Vendimi i KKPK është jo i drejtë dhe ligjor.

11. Pala ankuese tutje në ankesë kryesisht e përshkruan rrjedhën e procedurës sipas kërkesës së tij të ushtruar në KKPK, të drejtën në pronën e kërkuar në tërësi e bazon në dokumentet të cilat ja ka bashkangjitur kërkesës, duke i përshkruar faktet sipas këtyre dokumenteve, në bazë të cilave pretendon se është pronar legjitim i pronës së kërkuar sepse nuk e ka bere ndryshimin ne kadaster per faktin e obligimit të qe te kthehet posedimi për arsye se me kontratën për shitblerjen ai është bërë pronarë
12. Në fund pala ankese kërkon që Gjykata Supreme pas shqyrtimit dhe vërtetimit të fakteve dhe provave, të nxjerrë vendim me të cilin e anulon vendimin e ankimuar të KKPK-së dhe lëndën ta kthej në ri procedurë,

### **Pranueshmëria e ankesës**

13. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejme LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjeti se ankesa është e pranueshme dhe e afatshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së.

### **Meritat e ankesës**

14. Gjykata Supreme, shqyrtoi Vendimin e ankimuar dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese në ankesë dhe përmbajtjen e dosjes së lëndës, në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr,03/L-006, konstaton se Vendimi KKPK-së, nuk është i përfshirë me asnjë lëshim thelbësor procedural, zbatim të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë me vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të fakteve ashtu si theksohet në ankesë. Prandaj, ankesa nuk mund të miratohet.

### **Arsyetimi ligjor**

15. Gjykata Supreme, pasi shqyrtoi pretendimet në ankesë dhe përmbajtjen e dosjes së lëndës, konstaton se Vendimi KKPK-së nuk është i përfshirë me asnjë gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale dhe as nuk mbështetet në vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të fakteve. Prandaj ankesa nuk mund të miratohet.
16. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja, ka kompetencë të zgjidh kërkesat pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin dhe kërkesat për të drejtën pronësore, “që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20

qershor 1999, apo që rezultojnë nga ai. Prandaj paraqitësi i kërkesës duhet të paraqes jo vetëm titullin e pronësisë mbi pronën e paluajtshme private, por edhe të dëshmoj se ai apo ajo nuk është në gjendje ti ushtroj këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë me, apo rezultojnë nga konfliktit i armatosur.

17. Nga provat në shkresa të lëndës të administruara nga KKPK-aj, pa dyshim vërtetohet se prona e kërkuara nuk ishte humbur si pasojë e konfliktit të viteve 1998-99, ashtu si pretendon pala ankuese. Nuk ishte realizuar fitimi i pronës në kuptim të dispozitave ligjore dhe prona nuk ishte marr në posedim. Për këtë arsye edhe humbja e posedimit nuk mund të konsiderohej se ishte humbur si pasojë e konfliktit.
18. Nga faktet e theksuara nga vetë pala ankuese si më lartë, shënimeve kadastrale të ekzaminuara *ex officio* në tërësi provohet se prona të cilën e kërkon pala ankuese, nuk është humbur si pasojë e rrethanave të konfliktit të viteve 1998/99, sepse sipas palës ankuese kontesti ishte sepse në tërësi objekti i kërkesës ishte i pa ndarë në mes bashkëpronarëve. Pra sipas evidences kadastrale ngastra ishte bashkepronësi e 16 personave fizik e cial nuk ishte ndare fizikisht por vetëm në pjesë ideale.
19. Dokumentet e paraqitura nga pala ankuese dëshmojnë bashkepronësi mbi ngastren dhe Gjykata Supreme nuk i vë në dyshim të drejtat që dalin nga Kontrata e shitblerjes dhe as që i merr në shqyrtim për faktin se pala ankuese nuk ka mundur të konstutuojë një të drejtë pronësore të cilën do ta humbiste si pasojë e luftës. Shqyrtimi i meritave të kontratës dhe raportit i palës ankuese me bashkëpronarët e tjerë dhe me shitësin e pronës bien jashtë juridiksionit të KKPK-së në kuptim të nenit 3.1 të Ligjin nr. 03/L-079.
20. Gjykata Supreme, sipas konkludimeve të cekura si më lartë, theksimeve në ankesë dhe provave në shkresa të lëndës vlerëson se pala ankuese nuk ka dëshmuar se humbja e posedimit të pronës së kërkuara ka të bëjë me konfliktin. Andaj padysim vërtetohet se KKPK, si në vendimin e saj, me të drejtë dhe bazë ligjore ka marrë vendim të drejtë kur ka gjetur se kërkesa e palës ankuese nuk është në përputhje me nenin 3.1, paragraf 3., të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, për tu shqyrtuar dhe vendosur, andaj në mungesë juridiksioni nga AKP-ja për të vendosur mbi meritat e kërkesës është hedhë poshtë.
21. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese, apo palës së interesuar lidhur me të drejtën pronësore dhe as nuk paraqet pengesë për iniciimin e procedurës ushtrimin e një kërkesë para organit apo gjykatës kompetente, nëse vlerësohet me interes legjitim.
22. Nga të lartë cekurat e në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore:**

Sipas nenit 13.6, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**GSK-KPA-A-019-2019 me datën 20 Maj 2019**

**Bashkp. Profesional**  
**Sherif Krasniqi**

**KRYETARI I KOLEGJIT**  
**Beshir Islami**